Ju vini në Shtetet e Bashkuara të Amerikës përkohësisht për të punuar apo studiuar?

Ne jemi të siugurt që ju do të keni një qëndrim interesant dhe shpërblyes. Megjithatë nëse do të ndesheni me ndonjë problem, ju keni të drejtën për të patur dhe kerkuar ndihmë!

Ju keni të drejtë:

- Të pauguheni dhe trajtoheni me meritë;
- Të mos mbaheni në punë kundër vullnetit tuaj;
- Të mbani pasaportin tuaj dhe dokumentet tjera në posedimin tuaj;
- Të raportoni abuzimet pa hakmarje;
- Kërkoni ndihmë nga Sindikatat, Grupet për të drejtat e imigrantëve dhe punëtorëve dhe grupeve tjera; dhe
- Kërkoni drejtësi ne Gjykatat e Shteteve të Bashkuara.

Këto të drejta dhe të tjera janë të shpjeguara në këtë fletushkë.

✂ -

Nëse jeni keqtrajtuar apo drejtat e juaja janë shkelur, telefononi në keto numra telefoni falas:

Qendrën e të dhënave kombëtare për trafikimin e qenieve njerëzore 24 orë Linje e Hapur Telefonike Falas

1-888-373-7888

(E udhëhequr nga OJQ)

Linja e paraqitjes së ankesave grupit punues të trafikimit me qenie njerëzore dhe të eksploatimit të punëtorëve

(E hënë- E premte, 9am-5pm Estern Time)

1-888-428-7581

(E udhëhequr nga Departamenti i Drejtësisë së SHBA)

Nëse jeni në rrezik nga sulmi fizik, telefononi 911

Për më shumë ne lidhje me të drejtat për trajtimin dhe pagimin e juaj te drejtë në vendin e punës shiko faqen 5

Për më shumë ne lidhje me të drejtat për mbajtjen e juaj ne vendin e punës kunder vullnetit tuaj, shif faqen 7

Kjo fletushkë u krijua si rezultat i Ligjit Publik 110 -457 i Ligjit Federal i Shteteve të Bashkuara. Qeveria e SHBA ka lëshuar këtë fletushkë për nder të sundimit te ligjit dhe respektimit të dinjitetit të të gjithë atyre që vijnë në këtë vend. Qeveria e SHBA është e angazhuar në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe shkeljeve të drejtave të punëtorit.

MBAJ MEND!!

Ka shumë mënyra për të mbrojtur veten

- **Mbani pasaportën tuaj në vend të sigurtë dhe lehtësisht të aritshëm në çdo kohë;**
- **Mbani një kopje të pasaportës, vizës dhe kontratës së punës tuaj në vendlindjen tuaj, tek të afërmit apo miqtë;**
- **Gjithmon mbaje të regjistruar numrin e ambasadës së vendit tuaj;**
- **Mbajeni këtë pamfletë gjithmon pran vetes që ti referoheni kur të arini ne SHBA;**
- **Regjistroni të gjitha ditët dhe orët që i punoni dhe datën dhe shumën e rrogës që ju e merni; dhe**
- **Nëse keni nevoj për ndihme telefononi National Human Trafficking Resource Center's 1-888-373-7888 (24 orë) ose Trafficking in Person and Work Exploitation Task Force Complain Line në 1-888-428-7581(E hënë- E premte, 9am-5pm Estern Standard Time).**

Përshkrim i procesimit të vizave joimigruese

Çfar është viza joimigruese?

Viza joimigruese është një dokument i qeverisë amerikane që lejon individët të cilët udhëtojnë në Shtetet e Bashkuara të kërkojnë hyrjen për një qëllim të caktuar, për shembull, për të punuar apo për të studiuar.

Procesimi i vizave joimigruese përfshin dy hapa të rëndësishëm:

1. Aplikimi në ambasadën apo konsullatën e duhur të Shteteve te Bashkuar, dhe
2. Prezantimi i vizës inspektorit të imigracionit në kufirin e Shteteve te Bashkuara.

Cilat janë pjesët e rëndësishme të dokumenatcionit tim?

Sygjerim

Para se të udhëtoni për në Shtetet e Bashkuara, bëni dy kopje të të gjitha dokumentacioneve të rëndësishme, veçanërisht të pasaportës tuaj (me vizë), kontratës dhe dokumenteve të tjera të identifikimit. Dërgo një sërë kopjesh të këtyre dokumenteve dikujt që ju i besoni në vendin tuaj të origjinës. Kur të mbërrini në Shtetet e Bashkuara dhe kur të pranoni kartelën I-94, bëni një kopje të kartelës që ta keni në rast se ju e humbni origjinalin.

1. Viza. Ajo është e vendosur në pasaportën tuaj dhe tregon foton tuaj dhe datën e skadimit të vizës. Nëse viza e juaj skadon, ju nuk mund të hyni në Shtetet e Bashkuara me atë vizë deri sa ajo të përtërihet.

- Nëse ju keni një vizë në bazë punësimi, viza do të përfshijë emrin e punëdhënësit i cili është sponsori juaj i punës në Shtetet e Bashkuara.
- Viza e juaj për punë të përkohshme nuk ju jep leje për të punuar për cilin do punëdhënës që ju e zgjidhni, ajo është leje për të punuar vetëm për punëdhënësin e shënuar në aplikimin tuaj për vizë. Vetëm në raste të rralla, mund të jetë e mundur të ndryshohet punëdhënësi.
- Kjo nuk do të thotë që ju duhet të vazhdoni të punoni për punëdhënësin tuaj nëse punëdhënësi ju keqpërdor ose ju shfrytëzon.

2. Kartela I-94. Kjo është një kartelë e bardhë që do të ju jepet kur të hyni në Shtetet e Bashkuara. Kartela e juaj I-94 e tregon periudhën e kohës që do të ju lejohet të qëndroni në Shtetet e Bash-kuara.

   Mos e humbni këtë kartelë!

Sygjerim

Pasi të keni arritur në SHBA, mbani pasaportën tuaj dhe dokumentet e tjera të udhëtimit në vend të sigurt dhe lehtësisht të aritshëm në çdo kohë! Është e paligjshme për punëdhënësin tuaj të mban pasaportën tuaj larg nga ju!

Drejtat e juaja në vendin e punës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Ka disa masa mbrojtëse që janë specifike për llojin e vizës që ju e merrni.
Ato janë të përshkruara më poshtë sipas kategorisë së vizave.

A-3, G-5 dhe B-1 vizë për Ndihmës shtëpiak/shtëpiake

- Nëse ju punoni për një diplomat (A-3 vizë) apo për një përfaqësues të një organizate ndërkombëtare (G-5 viza), ose në qoftë se ju jeni një ndihmës shtëpie bartës i vizës B-1, atëherë punëdhënësi i juaj duhet t'ju japë një kontratë pune që është në përputhje me ligjin amerikan.
- Kontrata duhet të përfshijë dispozitat e mëposhtme:
  - Një marrëveshje nga punëdhënësi i juaj që të mos mban pasaportën e juaj, kontratën e punës apo ndonjë pronë tjetër të juajën;
  - Një marrëveshje nga punëdhënësi i juaj që ti përmbahet të gjitha ligjeve të Shteteve të Bashkuara;
  - Një shpjegim se sa dhe sa shpesh do të paguheni për punën tuaj; dhe
  - Një përshkrim të detyrave tuaja të punës, të orarit të punës, festave, ditëve të pushimit dhe pushimit mjekësor.
- Sigurohuni që i keni kuptuar kushtet e kontratës. Nëse ju nuk mund ta kuptoni gjuhën në të cilën është shkruar kontrata, pytni dikë në të cilin keni besim të ju lexojë kontratën në gjuhën që ju e kuptoni. Mos nënshkruani asgjë që nuk e kuptoni!
- Kur të aplikoni për vizë ju do të bisedoni me një konsull zyrtar amerikan dhe ai do të vërtetoj a është kontrata e juaj në përputhje me ligjin amerikan. Mos hezitoni ti parashtroni pyetje konsullit të SHBA. Punëdhënësi i juaj nuk është paraparë të jetë i pranishëm gjatë bisedës së juaj me konsullin e SHBA.
- Nëse keni nënshkruar një kontratë që i shkel të drejtat tuaja ose nëse punëdhënësi juaj nuk bën atë që thotë kontrata, menjëherë telefononi numrat e shënuara në këtë pamflet. Ata mund të ju ndihmojnë që të gjeni një avokat i cili mund të ndihmojë të ju shpjegojë të drejtat e juaja në këtë situatë.

H-1B dhe H-1B1 viza për kryerjen e shërbimeve në profesione të specializuara

- Nëse vini në Shtetet e Bashkuara për të kryer shërbime në një profesion të specializuar ose si një model/modele e modës, ju lutemi referohuni faqes www.Travel.State.gov për më shumë informacion në lidhje me të drejtat tuaja dhe mundësinë për ti ndryshuar punëdhënësit.

H-2A vizë për punë të përkohshme sezonale në bujqësi

- Nëse jeni punëtor i përkohshëm sezonal i bujqësisë, ju duhet të pranoni një përshkrim të kushteve të punësimit tuaj jo më vonë se dita e parë e juaj e punës. Ky dokument duhet të përmbajë informacione të detajuara rreth përfitimeve, pagës, strehimit, kohëzgjatjes së punës, transportit dhe përfitimet që punëdhënësi i juaj do t'ju ofroj.
- Ju keni të drejtë page në apo mbi nivelin e një pagë që është përcaktuar nga qeveria. Kjo normë vlen edhe nëse ju paguheni në orë ose me marëveshje.
- Ju nuk keni nevojë të paguani taksat dhe sigurim social të SHBA ose tarifat për rekrutuesin e punës në vendin e juaj.

- Punëdhënësi i juaj duhet të sigurojë strehim të pastër dhe të sigurt pa pagesë.
- Punëdhënësi juaj duhet të ju kompenzoj shpenzimet e transportit nga vend qëndrimi i juaj në vendin tuaj të punës, por vetëm pasi të keni përfunduar gjysmën e kohëzgjatjes së kontratës; dhe gjithashtu punëdhënësi i juaj duhet të paguajë për shpenzimet tuaja të transportit të udhetimit për kthimin tuaj pas përfundimit të kontratës.
- Ju keni të drejtën për punë të garantuar për të paktën 3/4 e numrit të ditëve të punës të deklaruara si kohëzgjatje e kontratës, vetëm nëse jeni zhvendosur nga një punëtor amerikan gjatë gjysmës së parë të kohëzgjatjes së kontratës.

H-2B vizë për punë të përkohshme sezonale jobujqësore

- Nëse ju jeni punëtor për punë të përkohshme jobujqësore, atëherë keni të drejtën të paguheni në apo mbi nivelin e një page të përgjithshme, e cila do të jetë të paktën e përcaktuar me ligjin federal, shtetëror ose me pagën minimale vendore ligjore por e cila mundet të jetë edhe më e lartë se niveli i përcaktuar. Kjo normë vlen edhe nëse ju jeni i paguar në orë ose me marëveshje.
- Punëdhënësi i juaj duhet të ju siguroj shpenzimet e transportit për kthim në vendin tuaj në qoftë se puna e juaj mbaron ose jeni larguar nga puna për arsye biznesi që ndërlidhet me performancën e juaj në punë para skadimit të kontratës.
- Ju zakonisht keni të drejtën të gëzoni kushtet dhe obligimet e punësimit që vljenë edhe për të punësuarit e tjerë të rregullt në SHBA, të punësuar nën kushte dhe rrethana të njejta.
- Ju kurrë nuk do të duhet të paguani taksat për rekrutuesin e punës në vendin tuaj.

J-1 vizë për vizitorë të shkëmbimit

- Në përjashtim të rastit kur programi i juaj i shkëmbimit është sponsorizuar nga qeveria federale, programi duhet të jetë në kohëzgjatje perj minimum tre javëve. Formulari DS-2019, dokumenti bazë i nevojshme për të aplikuar për një vizë J, reflekton kategorinë e shkëmbimit dhe datat e programit. Varësisht nga kategoria e shkëmbimit, mund të ketë dokumente tjera dhe/ose kontrata tjera që mbulojnë kushtet e programit të shkëmbimit tuaj.
- Reklamat e sponsorit tuaj duhet të jenë të sakta dhe ti shpjegojënë të gjitha shpenzimet, kushtet dhe kufizimet e programit të shkëmbimit. Sponsori i juaj duhet gjithashtu t'ju japë një orientim dhe t'ju japë informacion në lidhje me:
  - Programën J-1 dhe një përshkrim të veçantë të rregullave dhe programit në të cilin do të merrni pjesë;
  - Udhëtimin dhe hyrjen në Shtetet e Bashkuara;
  - Banimin
  - Tarifat dhe shpenzimet, duke përfshirë shpenzimet e jetesës, shëndetësisë dhe shpenzimet e sigurimit;
  - Jetën dhe zakonet në Shtetet e Bashkuara
  - Resurset lokale

- Adresën e sponsorit tuaj dhe emrin dhe numrin e telefonit të personit përgjegjës për ju në Shtetet e Bashkuara; dhe
- Kontakt informatat të Shërbimit të Programit për Visitor të Shkëmbimit të Departamentit të Shtetit; dhe
- Për broshurën e Programit të Shkëmbimit i Departamentit të Shtetit;

- Nëse ju hyni me Programin Verore për Punë dhe Udhëtim dhe paraprakisht nuk keni caktuar vendin e punës, atëherë sponsori juaj duhet të ju ndihmojë në gjetjen e punësimit nëse ju nuk kani gjetur punë brenda javës së parë pas mbërritjes tuaj dhe duhet të ju siguroj që ju të merrni pagën dhe përfitimet konform me ato të ofruara homologëve tuaj amerikanë.
- Nëse viza e juaj J-1 është për një program trajnimi dhe stazhi:
  - Sponsori juaj duhet të ju intervistoje personalisht, nëpërmjet telefonit ose me web kamerë;
  - Sponsori juaj duhet të ketë parashtruar një plan trajnimi / stazhi (Formulari DS-7002) para se të dorëzohet dokumentacioni i juaj për vizë. Ky formular përfshin një deklaratë me shkrim për çdo bursë apo që do të paguheni dhe një përmbledhje të synimeve të trajnimit të programit.
  - Sponsori juaj duhet të ju jep një deklaratë me shkrim të shpenzimeve dhe tarifave që ju do të duhet ti paguani dhe një vlerësim të shpenzimeve të jetesës në Shtetet e Bashkuara.
  - Trajnimi apo stazhi i juaj duhet të jetë të paktën 32 orë pune në javë; dhe
  - Nëse trajnimi apo stazhi i juaj është në laminë e bujqësisë, kushtet tuaja të punës dhe pagat duhet të plotësojnë kërkesat e rrepta federale për punëtorët e bujqësisë.
- Sponsori juaj duhet të sigurojë që ju të keni të mbuluar sigurimin mjekësor edhe pse sponsori juaj nuk ka nevojë të sigurojë apo të paguaj për këtë mbulim.
- Nëse ju punoni në Shtetet e Bashkuara, ju duhet të aplikoni dhe të merni numrin tuaj të Sigurimit Social dhe punëdhënësi i juaj duhet të raportojë të gjitha ndalesat tatimore duke përdorur këtë numër.
- Nëse e sjellni bashkëshortin/en apo fëmijët e juaj të mitur me ju në një vizë J-2, ata mund të aplikojnë për leje pune vetëm në qoftë se të ardhurat nuk janë të nevojshme për të ju mbështetur.

Për më shumë informacion mbi kategoritë e vizave dhe procedurat e hyrjes në SHBA, shih faqen e internetit të Departamentit të Shtetit te SHBA:

www.Travel.State.gov

Të drejtat e juaja pavarësisht nga statusi i vizës

Poashtu ka shumë të drejta të cilat ju takojnë pa mare parasysh statusin tuaj për vizë. Nëse ndonjë nga këto të drejta ju shkelen, ju mund të raportoni shkeljet tek agjencitë qeveritare për zbatimin e ligjit. Në shumicën e rasteve, ju gjithashtu mund të dorëzoni një padi në përpjekje për ti kthyer humbjet e juaja, pa frikë se do të ndëshkoheni.

1. E drejta e juaj që të mos ju kushtëzojnë

- Është e paligjshme për punëdhënësin tuaj të përpiqet t'ju ndëshkoj, për shembull, duke ju kërcënuar të ju raportoj në imigracion apo polici në qoftë se ju përpiqeni ti zbatoni të drejtat e juaja! Nëse punëdhënësi i juaj ju kërcënon në çdo kohë, menjëher kërkoni ndihmë.
  Mos harroni, siguria e juaj vjen në rend të parë!

2. E drejta për t'u paguar

- Ju keni të drejtën të paguheni për gjithë punën që ju e bëni, në të njëjtën mënyrë si punëtorët amerikanë.
- Ju keni të drejtë të fitoni të paktën minimumin e pagës ligjore federale prej $6,55 në orë, dhe $7,25 në orë duke filluar që nga 24 korrik 2009, në të njëjtën mënyrë si edhe punëtorët amerikanë. Gjithashtu kontrolloni:
  - Pagën minimale për shtetin në të cilin ju punoni. Në qoftë se ajo paga është më e larta, ju keni të drejtë për t'ju paguar shumën më të lartë.
  - Kontratën e juaj të punësimit, e cilat mund të detyrojë punëdhënësin tuaj të paguaj pagën më të lartë.
- Shumica e punëtorëve në Shtetet e Bashkuara kanë të drejtë të punojnë jashtë orarit dhe të paguhen një herë e gjysmë nga shuma e rrogës së tyre për çdo orë që kanë punuar mbi 40 orë në javë. Për shembull, në qoftë se norma e juaj e rregullt e pagës është $10 për orë, punëdhënësi juaj do të duhet që të ju paguaj 15$ për çdo orë pune mbi 40 orë pë një javë.
- Nëse punëdhënsi i juaj ju merr para nga paga e juaj, kjo do të quhet një heqje. Shumica e heqjeve janë të paligjshme nëse ato zvogëlojnë pagën e juaj të garantuar me ligj. Për shembull një punëdhënës zakonisht nuk mund të bën heqje për strehimin e ofruar (me disa klasifikime të vizave, strehimi duhet të ofrohet falas), për shumicën e uniformave, paisjeve të sigurisë apo për tarifat e rekrutimit.

Sygjerim

Sigurohuni që të mbani shënime për të gjitha orët e punuara. Merrni një fletore dhe shkruani të gjitha ditët dhe orët që keni punuar, sa jeni paguar, ditët që keni marrë pagën dhe për çdo ndalesë nga çeku i pagës tuaj dhe arsyet për ato ndalesa.

3. E drejta juaj për të mos u diskriminuar

- Si një punëtor, ju keni të drejtë të mos trajtoheni ndryshe apo keq në punë për shkak të gjinisë tuaj, racës, ngjyrës, origjinës kombëtare, fesë, apo për shkak të aftësive të kufizuara.

- Punëdhënësi juaj duhet të paguaj të njëjtën sasi për çdo punëtor për punën e njëjtë dhe të ofroj çdo punëtorit të njëjtat mundësi punësimi pa marrë parasysh gjininë e punëtorit, racës, origjinës kombëtare, ngjyrës, fesë, apo aftësisë së kufizuar.
- Punëdhënësi juaj nuk mund të ju bëjë të flisni vetëm në gjuhën angleze në punë nëse nuk ka ndonjë arsye të rëndësishme biznesi ku kërkohet gjuha angleze.

4. Të drejtat e juaja si një punëtor grua

- Punëdhënësi juaj NUK MUND të ju trajtoj ndryshe apo keq, prë shkak se ju jeni një grua apo jeni shtatzënë – kjo paraqet dis-kriminim gjinor. Pa mare parasyshë a jeni grua ose burrë, punëdhënësi juaj nuk guxon të ju ngacmojë seksualisht. Punëdhënësi juaj kurrë nuk duhet:
  - Të kërkoj që të kryeni akte seksuale;
  - Të ju ngacmoj në mënyrë seksuale; ose
  - Të ju thot ose bërtas komente seksuale apo fyese.

Sygjerim

Mbani shënime të detajuara të çdo komenti apo veprimi të padëshirueshëm që do të ndërmerr punëdhënësi i juaj kundër jush dhe shënoni emrat dhe numrat e telefonit të të gjithë dëshmitarëve.

5. E drejta juaj për një vend pune të shëndosh dhe të sigurt

- Të gjithë punëtorët kanë të drejtën për kushte të sigurta dhe të pastërta të punës:
  - Banimi: Nëse punëdhënësi i juaj ju ofron banim, ai duhet të jetë i pastër, i sigurt dhe me një ndërtim të fortë.
  - Banjë: Banjoja duhet të jetë e pastër dhe në afërsi.
  - Uji i pijshëm: Nëse punoni në bujqësi, në shumicën e rasteve, keni të drejtë për të keni ujë të pastër për të pirë dhe për ti larë duart e juaja.
  - Sëmundje apo lëndim në punë: në qoftë se jeni lënduar apo keni marrë sëmundje në punë ju mund të kërkoni trajtim mjekësor. Në shumicën e rasteve, ju do të pranoni trajtim mjekësor falas dhe një pjesë të pagës së humbur deri sa keni qenë i sëmurë apo i lënduar.
- Nëse jeni duke punuar me ose ndodheni në presence të pesticideve apo kimikateve të rrezikshme:
  - Ju keni të drejtë për të larë duart e juaja me ujë të pastër, pas trajtimit me pesticide apo kimikate. Ju keni të drejtë të trajnoheni mbi sigurin ndaj pesticideve gjatë 5 ditëve të para të punës.
  - Punëdhënësi juaj duhet të ju tregojë se ku dhe kur janë spërkatur pesticidet për të shmangur daljet aksidentale. Punëtorët dhe të tjerët nuk duhet të jenë në një zonë ku pesticidet janë duke u aplikuar.

K U J D E S !

Punëdhënësi i juaj nuk mund t'ju detyrojë të bëni diçka apo të shkoni diku, madje edhe mbrapa në shtetin e juaj, duke mos ju dhëne pagën.

- Në qoftë se ju përzini apo përdorni pesticide që kërkojnë nga ju të përdorni pajisje mbrojtëse (si kominoshe, një maskë ose respirator), punëdhënësi juaj duhet t'ju japë pajisje që është e pastër dhe në gjendje të mirë.

- Urgjencat mjekësore: Në rast të ndonjë urgjence, telefononi 911 dhe kërkoni për një ambulancë.

- Shpenzimet e juaja mund të paguhen, kështu që ju duhet ti tregoni punëdhënësit tuaj sa më shpejt që është e mundur që punëdhënësi i juaj të mund të paraqes dokumentet e nevojshme.

- Kur ndodheni tek mjeku apo në një klinikë, kërkoni kopjet e dokumentacionit në lidhje me sëmundjen apo lëndim tuaj.

6. E drejta juaj për t'ju bashkuar Sindikatës dhe negociuar kolektivisht

- Me disa përjashtime, sipas ligjit federal të gjithë punëtorët në Shtetet e Bashkuara kanë të drejtë të formojnë dhe ti bashkohen një sindikate, pavarësisht statusit të tyre të imigracionit. Punëdhënësi juaj nuk mund të ndërmarrë veprime kundër jush në qoftë se ju veproni kështu. Kjo do të thotë që ju mund të:

- Bashkoheni me punëtorë të tjerë për të përmirësuar pagat dhe kushtet e punës;

- Merrni pjesë në fjalime publike, mitingje dhe demonstrata; dhe

- Bashkoheni një sindikate ose organizate tjetër të punëtorëve.

7. E drejta e juaj për më tepër mbrojtje sipas ligjit të shtetit

- Telefononi linjat e drejtpërdrejta të shënuara në këtë pamflet për një rekomandim për organizatat që mund t'ju informjnë në lidhje me të drejtat tuaja në shtetin ku jeni duke punuar.

8. E drejta juaj për të lënë një punë ku ju shkaktohen situata abusive

- Ju nuk jeni i obliguar të qëndroni në punën tuaj nëse punëdhënësi i juaj ju abuzon në vendin e punës.

- Por, në qoftë se ju keni ardhur në Shtetet e Bashkuara me një vizë e bazuar në punësim dhe ju e lini punëdhënësin tuaj, atëherë statusi i juaj i vizës nuk do të jetë i vlefshëm. Megjithatë, varësisht nga lloji i vizës që ju keni, ju do te mundeni të jetni në gjendje të ndryshoni kategorinë e vizës apo të punëdhënësit. Ju gjithashtu do të mundeni të jeni në gjendje të qëndroni legalish në Shtetet e Bashkuara që të ndjekni një padi ligjor.

- Ju gjithashtu mund të bëni një ankesë formale ose të ngreni një padi kundër punëdhënësit tuaj, dëri sa ju jeni ende duke punuar. Ka dënime të rrepta për një punëdhënës i cili përpiqet për të ndëshkuar punëtorët për shkak se ata kërkojnë të drejtat e tyre.

Sygjerim

Ju keni të drejta në Shtetet e Bashkuara dhe askush nuk mund t'ju merrë ato. Egzistojnë me qindra organizata që mund t'ju ndihmojnë. Mos kini frikë të kërkoni ndihmë për të mbrojtur të drejtat e juaja.

- Nëse jeni duke përjetuar probleme me punëdhënësin tuaj të tanishëm, kontaktoni linjat e drejtpërdrejta të shënuara në këtë broshurë. Ata do të mund të ju lidhin me një organizatë lokale që mund të flasin me ju në lidhje me opsionet tuaja.

Trafikimi i Qenie Njerëzore

1. Çfar është trafikimi i qenieve njerëzore?

Trafikimi i qenieve njerëzore është ndër abuzimet më të tmerrshme që mund të hasë një individ në vendin e punës në Shtetet e Bashkuara. Trafikimi i qenieve njerëzore ndodh sa herë që një person është i rekrutuar, transportuar ose mbahet kundër dëshirës së tij për qëllime të shfrytëzimit. Për një përshkrim të plotë të trafikimit të qenieve njerëzore, ju lutemi shikoni në www.state.gov /g/tip (shih Legislations-Trafficking Victims Protection Act). Në vijim janë disa shenja paralajmëruese që mund të tregojnë se keni te bëni me trafikim të qenieve njerëzor:

Kërcënim dhe Frikë:

Punëdhënësi dhe njerëzit që ndihmojnë punëdhënësin, mund të përdorin kërcënime dhe akte të tjera kërcënuese për të bërë që ju dhe punëtorët e tjerë të ndjeheni shumë të frikësuar që të përpiqeni të leni vendin e punës. si për shembull:

- Rrahje, abuzim fizik apo abuzim seksual;
- Kërcnime për rrahje, abuzim fizik apo abuzim seksual;
- Mbyllje apo zaptim të punëtorit;
- Kërcënimi apo dëmtimit të punëtorit ose familjes së punëtorit nëse punëtori përpiqet të largohet, ankohet për keqtrajtim, raportoj situatën tek autoritetet ose të kërkojë ndihmë;
- Kërcënimet e të qënit i deportouar apo arrestuar apo paraqitje në polici për arsy të përpjekjeve të punëtorit për tu larguar nga vendi i punës, shfaqje të pakënaqësisë, raportim ose të kërkuarit ndihmë për situatën e punonjësit;
- Punëdhënësi ose dikush që punon me punëdhënësin ka dëmtuar ose i është kërcënuar punëtorëve të tjerë të cilët janë përpjekur të largohen, ankohen, raportojnë ose të kërkojnë ndihmë ose bëjnë kërcënime se çdo punëtor të cilët përpiqen të ikin do të gjenden dhe do të kthehen prapa.

Regullat dhe Kontrollet:

Punëdhënësit dhe individët të cilët i ndihmojnë ata mund të përdorin rregulla dhe urdhëra për ta bërë më të vështirë për ju dhe punëtorët e tjerë për tu larguar nga vendi i punës, ankoheni për keqtrajtim ose kërkoni ndihmë. Për shembull:

- Rregullat kundër largimit nga vendi i punës ose rregullat e rrepta në lidhje se ku ju mund të shkoni kur nuk punoni;
- Rregullat kundër mbajtjes së pasaportës suaj, vizës, çertifikatës së lindjes apo të dokumenteve të tjera identifikuese;
- Mohimi i ushqimit adekuat, fjetjes ose të kujdesit mjekësore, ose
- Parandalimin apo kufizimin e juaj nga komunikimi i lirshëm me familjen, punëtorët e tjerë, apo të tjerët jashtë vendit të punës.

Mashtrimet dhe Gënjeshtrat:

Punëdhënësit dhe individë të cilët i ndihmojnë ata, mund të përdorin gjithashtu edhe mashtrimin dhe gënjeshtrat. Për shembull:

- Premtime të rreme rreth kushteve të punës, kushteve të jetesës, ose të pagës;
- Ju tregojnë se ju nuk keni të drejta;
- Ju tregojnë se nuk do të ju besojnë nëse ju përpiqeni të kërkoni ndihmë; dhe
- Ju udhëzojnë të gënjeni për identitetin e tyre.

Sygjerim

Përpara se të niseni për në Shtetet e Bashkuara, flisni me organizatat e punëtorve imigrant apo me ish-punëtorët imigrant për emrat dhe numrat e personave ose organizatave që do të mundeni ti kontaktoni në qoftë se keni probleme ose pyetje gjatë qëndrimit tuaj në Shtetet e Bashkuara.

2. Çfarë duhet të bëj në qoftë se këto gjëra janë duke më ndodhur mua?

- Nëse ndonjë prej këtyre gjërave po ju ndodhin ose ndodheni në një situatë të rrezikshme, kërkoni ndihmë menjëherë duke telefonuar 911, Qendrën e të dhënave kombëtare për trafikimin e qenieve njerëzore (1-888-373-7888) ose Linja e paraqitjes së ankesave grupit punues të trafikimit me qenie njerëzore dhe të eksploatimit të punëtorëve (1-888-428-7581). Ata mund të ndihmojënë të ju rekomandojënë tek një organizatë lokale që ndihmojnë viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në zonën tuaj.
- Nëse ju jeni fizikisht I rezikuar, ju duhet të telefononi 911 për të marrë Policinë. Nëse ju telefononi policinë, tregoni atyre këtë fletushkë dhe tregoni në lidhje me abuzimin që ju keni pësuar.

3. A do të deportohem në qoftë se unë raportoj abuzimet?

Egzistojnë programe për të mbrojtur njerëzit që raportojnë abuzim. Ju nuk duhet të keni frikë të kërkoni ndihmë edhe nëse keni qështje me imigracionin. Në këto raste duhet të konsultoheni me një avokat imigracioni i cili nuk punon për punëdhënësin tuaj.Linja telefonike në këtë fletushkë mund t'ju ndihmojë të gjeni dikë për t'u konsultuar.

- Nëse besoni se mund të jeni një viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore ose i një krimi të rëndë, duke përfshirë përdhunim apo sulm seksual, ju mund të keni të drejtë për të ndryshuar vizën e juaj joimigruese ne një vizë T (për viktimat e trafikimit), ose një vizë U (për viktimat e krimeve të tjera të rënda). Këto viza janë krijuar për të siguruar mbrojtje për viktimat të caktuara të krimit të cilat janë të shqetësuar për statusin e tyre të imigracionit. Shumë njerëz nuk janë të njohur me këto viza dhe mund të kenë nevojë të pyesin që të ju ndihmohet në lidhje me to.

4. Cilat shërbime janë në dispozicion për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore?

- Nëse ju jeni një viktimë e trafikimit në Shtetet e Bashkuara, ju mund të keni të drejtën ligjore për përfitime, shërbime, dhe mjete ligjore të imigracionit në kuadër të programeve federale ose shtetërore.
- Shumë organizata mund të ju ndihmojë të hyni në këto shërbime, të cilat përfshijnë kujdesin mjekësor, kujdesin e shëndetit mendor, strehim, kujdes dentar, advokacisë ligjore për imigracionin dhe nevojat e tjera ligjore si dhe asistences për punësim dhe përfitime publike.

Informohu për të drejtat e tuaja

Telefononi një prej linjave të shënuara në këtë pamflet në qoftë se keni nevojë për ndihmë

Ju keni pranuar këtë fletushkë, sepse ju keni aplikuar për vizë jonimigruese për të punuar apo studiuar përkohësisht në Shtetet e Bashkuara. Qëllimi i kësaj fletushke është që t'ju ndihmojë të kuptoni të drejtat tuaja kur të mbërrini në Shtetet e Bashkuara. Edhe pse ju do të jetojni përkohësisht në Shtetet e Bashkuara, ju ende do të keni shumë nga të drejtat bazë të punës që qytetarët dhe banort amerikanë tash më i kanë.

Ky pamflet jep një pasqyrë të drejtave tuaja themelore të vendit të punës. Të kuptuarit e drejtave do të ju ndihmojë për të mbrojtur veten nga abuzimi. Mbajeni këtë pamflet me vete në Shtetet e Bashkuara në rast se keni nevojë për të kërkuar dikë për ndihmë.

Ky pamflet është krijuar gjithashtu për të ju ndihmuar të mbroni veten kundër abuzimeve më të rënda, të tilla si trafikimi i qenieve njerëzore. Trafikimi i qenieve njerëzore është një formë e skllavërisë të kohës moderne, ku një punëdhënës ose individ tjetër, nëpërmjet abuzimit fizik apo psikologjik, shkakton një individ të mendoj nëse ai ose ajo nuk është e/i lirë që të largohet nga situata e krijuar. Duke kuptuar se ju gjendeni në një situatë abuzive në vendin e punës paraqet hapin e parë për të kërkuar ndihmë.

Në qoftë se ju mbërrini në Shtetet e Bashkuara dhe keni probleme në punë, ju duhet të kërkoni ndihmë menjëherë. Mos i besoni punëdhënësit tuaj nëse ai ose ajo thotë se ju nuk keni të drejta ligjore në Shtetet e Bashkuara. Mos pranoni këshilla ligjore nga kontraktori i juaj, punëdhënësi ose rekrutuesi. Vetëm një avokat që ju përfaqëson duhet të ju jap këshilla ligjore.

Nëse besoni se të drejtat e juaja shkelen, numrat e telefonit të shënuara në këtë pamflet mund të ju ndihmojë të kontaktoni organizatat lokale që mund të ju ofrojnë asistencë të mëtutjeshme. Mos kini frikë të kontaktoni këto organizata! Ata janë këtu për t'ju ndihmuar.

Ky pamflet nuk është një zëvendësim për këshilla ligjore. Ka shumë lloje të ndryshme të vizave për punë dhe vizave për shkollim, dhe ju nuk duhet të keni frikë të kërkoni më shumë informacione në lidhje me vizën tuaj.

NËSE TË DREJTAT TUAJA JANË SHKELUR, TELEFONINI KËTO NUMRAT TELEFONI FALAS:

Qendrën e të dhënave kombëtare për trafikimin e qenieve njerëzore
1-888-373-7888
(24 orë)

Linja e paraqitjes së ankesave grupit punues të trafikimit me qenie njerëzore dhe të eksploatimit të punëtorëve
1-888-428-7581
(e hënë – e premte, 9am -5pm Koha e zones lindore)